



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA VUSHTRRI - OPŠTINA VUČITRN	
01 N. / Br.	36 / 23
Nr. f. / Br. n.	- 3 -
Ditë: / Date:	
10. 02. 2023	
VIZUELLIMI - VIZUALIZIMI	



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA VUSHTRRI
OPŠTINA VUČITRN

PROCESVERBAL

nga mbledhja e I-rë e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 16 janar 2023 në sallën e kuvendit të komunës, e cila filloj në ora 11:10.

Në mbledhje ishin të pranishëm: Melihate Basholli-Latifi (kryesuese), Ilmi Azemi, Nurie Halili, Agron Përçuku, Alban Bajrami, Fakete Dushi dhe Sylejman Meholl (anëtarë të KPF -së).

Munguan: Lorik Maxhuni dhe Fatmire Cecelia.

Gjithashtu në këtë mbledhje morën pjesë edhe: Drejtoret e drejtorive, Ismet Gashi, udhëheqës i zyrës ligjore, Haki Maloku nga zyra e kryetarit, si dhe Bujar Klinaku nga sekretaria e kuvendit.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e kuvendit dhe e KPF-së, e cila konstatoi se ekziston shumica e mjaftueshme për punë.

Ilmi Azemi, anëtar i KPF-së – propozoi që të futet pikë e veçantë e rendit të ditës <Shqyrtimi i Raportit analistik nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, për punën dhe të hyrat buxhetore për vitin 2022>, kurse materiali për kuvend të përgatitet. Ai e arsytoi me faktin se si kuvend nuk kanë njohuri mbi të arriturat, vlerësimet dhe dështimet e drejtorisë për vitin 2022.

Sylejman Meholl, anëtar i KPF-së – propozoi që në seancën e rregullt të përgatitet një informatë apo raport i punës së përgjithshme të Kryetarit të komunës dhe qeverisë komunale për vitin 2022.

Alban Bajrami, anëtar i KPF-së – tha se në seancën e kaluar u dakordua që në këtë mbledhje të sjelljet propozimi për caktimin e lokacionit për Kryqin e Kuq – dega në Vushtrri. Ai propozoi që të vjen si pikë e rendit të ditës në seancën e kuvendit.

Ismet Gashi, udhëheqës i zyrës ligjore – deklaroi se anëtari i kuvendit, sipas rregullores mund të propozojë pikë shtesë, kurse sa i përket asaj që mungon materiali për shqyrtim, është çështje e juaja që ta vlerësoni se a do ta shqyrtoni apo jo.

Haki Maloku, nga zyra e kryetarit – lidhur me kërkesën që e parashtroi z. Meholl, ai tha se me Plan të punës së kuvendit që është miratuar, rapporti i kryetarit dhe qeverisë komunale është planifikuar në muajin mars 2023.

Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri aprovoi këtë:

R E N D D I T E

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 14.12.2022;
 2. Shqyrtimi i Raportit për të hyrat dhe shpenzimet për periudhën janar – dhjetor 2022;
 3. Shqyrtimi i Raportit analistik nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, për punën dhe të hyrat buxhetore për vitin 2022;
 4. Të ndryshme.
-
1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 14.12.2022.

Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri aprovoi procesverbalin e datës 14.12.2022.

2. Shqyrtimi i Raportit për të hyrat dhe shpenzimet për periudhën janar – dhjetor 2022.

Sylejman Mehollı, anëtar i KPF-së – mund të konkludojmë se ka qenë një vit fatkeq dhe i dështuar, për shkak të përqindjes së ulët të realizimit buxhetor, sidomos tek pjesa më e rëndësishme që janë investimet kapitale. Meqenëse nuk janë të pranishëm në mbledhje as kryetari, as nënkyetari, e as drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, nuk e di se kush mund të na japë sqarime, por vetëm po konstatoj se për neve ky raport financiar është shqetësues dhe ky niveli i realizimit të buxhetit është shqetësues. Edhe tek shpenzimet, disa kategori të cilat në raport me vitet paraprake janë rritur ndjeshëm, kurse analizat, raportet dhe informatat shtesë do t'i kërkojmë në kuvend.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja me pesë (5) vota “për”, një (1) “kundër”, rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.

3. Shqyrtimi i Raportit analistik nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, për punën dhe të hyrat buxhetore për vitin 2022.

Melihate Basholli - Latifi, kryesuese e KK-së dhe e KPF-së – tha, pasi që nuk kemi material, pyeti nëse propozuesi ka ndonjë diskutim ose dikush tjetër.

Ilmi Azemi, anëtar i KPF-së – në cilësinë e propozuesit kërkoi nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit që për seancën e kuvendit të përgatitë materialin lidhur me këtë çështje:

- Cilat janë të arriturat e Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit për vitin 2022;
- Cili është vlerësimi apo dëmtimi i përfitimeve financiare për buxhet;
- Të gjitha kërkesat për legalizimin e objekteve banesore që ju kanë adresuar kësaj drejtorie (të futen në raport dhe të dërgohen fizikisht në kuvend), të saktësohet data, a kanë pasur leje ndërtimore këto banesa. Nëse kanë pasur leje ndërtimore, në bazë të cilit ligj i ka marrë prapë drejtoria për t'i trajtuar për legalizim?. Cilat janë shkaqet që është detyruar drejtoria prapë kur organi i njëjtë ka lëshuar leje ndërtimore për ndërtimin e një objekti afarist – banesor dhe prapë është aplikuar legalizimi?. A ka tejkalim apo shkelje të rregullave, normave?. Kush ka përfituar?. Sa është dëmtuar buxheti i komunës nëse ka ndodhur kjo?. Të gjitha këto të na raportohen në bazë të

librit të protokollit të drejtorisë me data të pranimit dhe me data nëse ka marrë vendim meritor apo refuzues;

- Të gjitha kërkesat lidhur me lejet ndërtimore sipas librit të protokollit të dërgohen në kuvend me datë dhe numër të aplikimit. Po ashtu, të raportohet për se cilën leje ndërtimore në raport. Sa ka zgjatur afati i marrjes së lejes ndërtimore, a janë respektuar afatet ligjore?. Ku gjendet fati i kërkesave të qytetarëve, sepse, informatat janë shumë të këqija, që po pritet nga 9 muaj, 12 muaj dhe siç tha ai pa shku me u “kryqu” diku, nuk po mund të pajisen qytetarët me leje.
- Raporti të përfshijë datën e aplikimit, sipas protokollit të pranimit dhe datën e vendimit përfundimtar, sipas protokollit për se cilën kërkesë të qytetarëve edhe për ndërtimet e ulëta;
- Raporti të paraqitet në mënyrë analitike për të gjitha kërkesat e drejtuara në Drejtorinë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, duke na informuar saktë, duke përfshirë datën e aprovimit/refuzimit të kërkesave sipas librit të protokollit zyrtar.

Azemi deklaroi se kjo kërkesë ka të bëjë me të hyrat buxhetore. Pra, ky raport do të pasqyrojë se a ka pasur dëmtim të buxhetit komunal, a ka pasur zhvillim qyteti me punën e kësaj drejtorie, apo ka pasur regres. Nëse nuk vjen rapporti sipas kërkesës sonë, atëherë do të shohim një mundësi të dytë se sa është dëmtuar buxheti i komunës me neglizhencën e kësaj drejtorie dhe përdorimin e mekanizmave joligjor.

Pas debatit për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja me gjashtë (6) vota “për”,asnje “kundër” dhe asnje “abstenim, rekandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.

4. Të ndryshme.


Agron Përçuku, anëtar i KPF-së – kërkoi informatë me shkrim nga Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale (pasi që drejtori nuk është i pranishëm në mbledhje) lidhur me skandalin në laboratorin e QKMF-së (lajm i publikuar në media lokale dhe qendrore), ku ishin arrestuar tre zyrtarë për “keqpërdorim të pozitës apo autoritetit zyrtar” dhe të njëjtët gjenden në vendin e punës, kërkoi informatë se:

- Me çfarë vendimi ata zyrtarë janë kthyer në vendin e punës?

Ai tha se isha i pranishëm në laboratorin e analizave, ku qytetarët duke sheshin mjaft të shqetësuar për këtë, një prej tyre jam edhe unë duke e ditur rastin që ka ndodhur dhe ata zyrtarë gjenden në vendin e punës.

Mbledhja përfundoi në orën **11:25**.

Bujar Klinaku


Procesmbajtës

Melihate Basholli - Latifi


Kryesuese e KK-së dhe e KPF-së